

Rehovë, gati projekti për restaurimin e kishës së Shën Kollit



Rehova, një prej perlave të Kolonjës dhe një thesar ende i pazbuluar është destinacioni turistik i cili ofron për vizitorët traditën, historinë dhe mikpritjen.

Këshilli Kombëtar i Restaurimeve ka miratuar projektin, “Ndërhyrje restauruese në Kishën e Shën Kollit”, në fshatin Rehovë, Kolonjë.

Projekti i hartuar nga Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Korçë parashikon ndërhyrje konservuese dhe restauruese në objekt.

Fshati i Rehovës është i njohur në të gjithë vendin për artizanatin, mikpritjen, gatimet e veçanta, bukuritë dhe trashëgiminë e pasur, të ruajtur deri në ditët e sotme.

Rehova piktoreske, e cila shtrihet në rrëzë të malit të Gramozit, është përzgjedhur në 100 fshatrat model dhe do krijojë të njëjtin itinerar si Voskopoja, duke i dhënë këtij fshati një zhvillim të ri turistik e ekonomik, përmes rijetëzimit të vlerave që

mbart si për turistët vendas, ashtu dhe për turistët e huaj.

— [ATSH](#)